

VENDIM
Nr.287, datë 28.4.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT PRANË SHKOLLËS SË
LARTË PRIVATE “KRISTAL”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në shkollën e lartë private “Kristal”, Tiranë, të programeve të studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) E drejtë publike;
- b) E drejtë penale;
- c) Financë.

2. Këto programe studimi të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë (DND)” në:

- a) E drejtë publike;
- b) E drejtë penale;
- c) Financë.

3. Hapjen në shkollën e lartë private “Kristal”, Tiranë, të programit të studimit të ciklit të tretë “Master i nivelit të dytë (MND)”, në formën e studimeve me kohë të plotë, në “Studime europiane”.

4. Ky program studimi i ciklit të tretë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë (MND) në studime europiane”.

5. Shkolla e lartë private “Kristal” Tiranë ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 1 e 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

6. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha